



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

**PROJEKTET FITUESE TË THIRRJES SË TRETË TË SHPALLUR NGA AGJENCIA  
KOMBËTARE E RINISË PËR GRANTE PËR INFRASTRUKTURË RINORE PËR NJËSITË E  
VETËQEVERISJES VENDORE**

<b>Nr.</b>	<b>Emri i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore</b>	<b>Titulli i Projektit</b>	<b>Përshkrimi i Projektit</b>	<b>Shuma e financimit nga AKR</b>
<b>1</b>	<b>Bashkia Mat</b>	RINOVART - Qendër Rinore multifunkionale, rekreative, inovacion dhe art	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rindërtimi dhe rivitalizimi i godinës së ish shkollës fillore Lagjia e Re Burrel dhe përdorimi i saj për të krijuar Qendrën Rinore Mat, me qëllim zhvillimin e iniciativave për forcimin e rolit të të rinjve në shoqëri dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik të tyre. Nëpërmjet rivitalizimit të qendrës synohet nxitja e lehtësimit i të rinjve drejt procesit të punësimit, përkrahja e iniciativave vullnetare në grup, ndërtimi i kapaciteteve të të rinjve për një ndikim konstruktiv në vendimmarrje për të përmirësuar shërbimet dhe politikat për interesin e rajonit, fuqizimi i komunitetit rinor, zhvillimin social dhe ekonomik nëpërmjet trajnimeve, programeve, punëtorive, praktikës profesionale, shkëmbimit të të rinjve dhe konferencave.	10.000.000 lekë
<b>2</b>	<b>Bashkia Korçë</b>	Rehabilitimi i Qendrës Rinore Korçë	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë ambjentet ekzistuese të Qendrës Rinore, duke ofruar një mjedis të përshtatshëm dhe bashkëkohor për të rinjtë, si hapësira për veprimtari kulturore, arsimore, artistike dhe sportive; programe edukative dhe formatuese që ndihmojnë të rinjtë në mësimin e aftësive të reja, përgatitjen për tregun e punës, dhe zhvillimin profesional; krijimi i një ambienti ku të rinjtë mund të shprehin kreativitetin e tyre dhe të marrin pjesë në aktivitete kulturore dhe artistike.	9.890.980 lekë
<b>3</b>	<b>Bashkia Sarandë</b>	Qendra Rinore Sarandë	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi i Qendrës Rinore Kreative Multifunkionale Sarandë, përmes hartimit të një programi me	10.000.000 lekë

			bazë komunitare në funksion të zhvillimit të të rinjve në Bashkinë Sarandë duke ofruar shërbime rinore të inkuorpuara në një mjedis kreativ. Kjo qendër vjen si domosdoshmëri për transformimin e vizionit të shoqërisë dhe krijimin e një mjedisi miqësor për të rinjtë që të kenë mundësi të rrisin kapacitetet e tyre dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në moshë të hershme.	
4	<b>Bashkia Malësia e Madhe</b>	Kompleksi Rinor “Syri i Sheganit”	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është krijimi i Kompleksit Rinor “Syri i Sheganit” – si model i shërbimit në komunitet duke promovuar pjesëmarrjen në vendimmarrje, këshillimin në karrierrë dhe të drejtat e njeriut, duke kontribuar në transformimin e jetës së të rinjve dhe komunitetit ku ata jetojnë dhe duke u bërë agjentë të ndryshimit pozitiv për shoqërinë. Projekti synon rivitalizimin e ambjenteve të jashtme dhe krijimin e kushteve bashkëkohore për të rinjtë, me qëllim zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën e bashkisë e të këshilluarit për karrierrë duke bërë të mundur që të ndryshojnë pozitivisht jetën e tyre dhe të investojnë për të ardhmen.	5.000.000 lekë
5	<b>Bashkia Librazhd</b>	Ndërtimi i një Qendre rinore në Bashkinë Librazhd.	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi i Qendrës Rinore në Bashkinë e Librazhdit duke përmirësuar jetën e të rinjve dhe zhvillimin e tyre në një mjedis pozitiv, mbështetës dhe inkurajues duke përfshirë aspekte të ndryshme të zhvillimit personal, arsimor, kulturor dhe shoqëror dhe duke i krijuar të rinjve një vend të dedikuar në mënyrë që të tregojnë kreativitetin dhe idetë e tyre në atë çfarë ata dinë të bëjnë më mirë.	7.500.000 lekë

6	<b>Bashkia Fier</b>	<p>SKYHIGH  RINOR: Projekti  i hapësirës së  Rinisë që  Shkëlqen mbi  Qytet</p>	<p>Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ngritja e një qendre multifunksionale rinore në ambientet e bibliotekës “Dritëro Agolli” në qytetin e Fierit, e cila ka për qëllim të ofrojë një hapësirë të re dhe të përshtatshme për aktivitetet e rinisë, duke i dhënë mundësinë komunitetit rinor të zhvillojë aftësitë dhe talentet e tyre dhe të ndikojë në zhvillimin e qytetit dhe të rajonit. Qendra synon të ofrojë një gamë të gjerë të shërbimeve dhe aktiviteteve që do të ndihmojnë në përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së të rinjve në qytetin e Fierit duke rritur vetëdijen e komunitetit për çështje të rëndësishme shoqërore dhe mjedisore dhe duke inkurajuar angazhimin dhe bashkëpunimin në zhvillimin e qytetit dhe rajonit nëpërmjet përfshirjes së të gjithë të rinjve në veçanti të atyre me aftësi të kufizuara dhe në kushte të disavantazhuara.</p>	7.500.000 lekë
---	---------------------	---	--	-------------------